



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**RADIKA**” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J77304705D**

Adresa: *Dibër, Peshkopi, PESHKOPI, L "GJOK DOCI".*

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Punë**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-05296-09-14-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstrukcion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social**”, me fond limit **10 699 137.5** (*dhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë*) **lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 4 881 951.66** (*katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë*) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit në vlerën: 3 812 037.5 (*tre milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë pikë pesë*) **lekë pa TVSH**, dhe nga grandit bashkisë në vlerën: 1 069 914.16 (*një milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë gjashtëmbëdhjetë*) **lekë pa TVSH, dhe për vitin 2022 në vlerën: 5 817 185.83** (*pesë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre*) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit, me afat realizimi: **4 (katër) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 140, datë 20 Shtator 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “RADIKA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J77304705D**

Vlera: 10 640 108 (*dhjetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e njëqind e tetë*) **lekë pa TVSH**

2. Operatori Ekonomik: “2 N” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31615017L**
Vlera: **8 111 824** (tetë milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e katër) **lekë pa TVSH**
3. Operatori Ekonomik: “ALB-KON” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K06626411C**
Vlera: **7 854 297** (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**
4. Operatori Ekonomik: “AVDULI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66703306O**
Vlera: **8 923 204** (tetë milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e katër) **lekë pa TVSH**
5. Operatori Ekonomik: “SARDO” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K13120402W**
Vlera: **8 415 636** (tetë milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**
6. Operatori Ekonomik: “VALONA KONSTRUKSION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K26330202E**
Vlera: **10 157 293.5** (dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesë) **lekë pa TVSH**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “2 N” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31615017L**
2. Operatori Ekonomik: “ALB-KON” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K06626411C**
3. Operatori Ekonomik: “AVDULI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66703306O**
4. Operatori Ekonomik: “SARDO” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K13120402W**
5. Operatori Ekonomik: “VALONA KONSTRUKSION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K26330202E**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “2 N” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**
- I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**
 - “1. ***Ofertuesi duhet të paraqesë:***
 - a. ***Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...***”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit* është deklaruar nga vetë Op. Ek. Pjesëmarrës në seksionin B “*Deklarata “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”* pika 8, 9 dhe 10 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka patur konsultim, komunikim... me ndonjë konkurrent tjetër, si dhe në seksionin D “*Deklarata “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”* pika 3 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka masë efektive ligjore të vendosur nga ISHPSHSH, ku bazuar në nenin 76 pika 3, gërma “a” duhet të s’kualifikohet.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- a) *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafi inxhinierik si më poshtë:*

- *Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- *Minimuni 1 (një) Inxhinier Elektrik*

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast të shpalljes si operator ekonomik fitues, përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, për inxhinierin elektrik, paga e përcaktuar në Kontratën e punës (noteriale) vjen në kundërshtim me VKM-në Nr.1025, datë 16.12.2020 “*Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*”.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

- a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 ton, jo më pak se 2 copë...

- b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:*
- *Kokore – jo më pak se 8 copë*
 - *Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë*
 - *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – jo më pak se 3 copë*
 - *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 2 copë...*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
 1. Nuk vërtetohet disponimi i 2 (dy) matrapikëve, por vetëm 1 (një) të tillë, pasi nuk është paraqitur foto për të 2 (dy) pajisjet matrapik, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7.
 2. Nuk vërtetohet disponimi i pajisjeve kokore, komplet i ndihmës së shpejtë dhe Tabela paralajmëruese..., pasi nuk është paraqitur foto për këto pajisje, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7.
 3. Për pajisjen: *Vinç 0,5* rezulton se Faturat tatimore shitje për blerjen e tij, nuk është e plotësuar sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre, si dhe nuk paraqitet pesha ngritëse e vinçit.

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “ALB-KON” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:
 “1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...*”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit* nuk është deklaruar i gjithë informacioni që kërkohet, si dhe në seksionin A Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nuk është e plotësuar saktë sipas kërkesave që përmban.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

– *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

ose

– *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100% e fondit limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, për vërtetimin e punëve të ngjashme me entin publik, nuk janë paraqitur të gjitha faturat tatimore shitje për punimet e kryera.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 8 (tetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Murator – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Pllakashtrues – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Suvatues – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Bojaxhi – jo më pak se **1 (një)** punonjës

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast të shpalljes si operator ekonomik fitues, përpara

nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin: Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi për teknikun e ndërtimit, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën, muaji Korrik 2021 e në vazhdim.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se,**
 - 1. Nuk janë paraqitur Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) për punonjësin me specialitetin e kërkuar.**
 - 2. Punonjësi i deklaruar me specialitetin Bojaxhi, nuk figuron në listëpagesat për periudhën Korrik 2021 e në vazhdim.**
 - 3. Për punonjësit me specialitetin Teknik Ndërtimi, Murator dhe Bojaxhi, paga e përcaktuar në Kontratrat Individuale të punës vjen në kundërshtim me VKM-në Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 ton, jo më pak se 2 copë...

b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:*

- *Kokore – jo më pak se 8 copë*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – jo më pak se 3 copë*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 2 copë...*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**
 - 1. Faturat tatimore shitje për blerjen e pajisjes Depozitë uji 5000 litra, është paraqitur fotokopje.**
 - 2. Për pajisjet: Depozitë uji 5000 litra, Vinç 0,5 ton, Skeleri Betoniere 0.25 - 0.5 m³, Gjenerator, Matrapik, si dhe mjetet dhe pajisjet mbrojtëse në punë, rezulton se nuk janë paraqitur foto për këto pajisje, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7.**

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “AVDULI” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:
“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit* është deklaruar nga vetë Op. Ek. Pjesëmarrës në seksionin B “*Deklarata “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”* pika 8, 9 dhe 10 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka patur konsultim, komunikim... me ndonjë konkurrent tjetër, si dhe në seksionin D “*Deklarata “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”* pika 3 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka masë efektive ligjore të vendosur nga ISHPSHSH, ku bazuar në nenin 76 pika 3, gërma “a” duhet të s’kualifikohet.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **100%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit

- iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi Faturat Tatimore Shitje për kontratat e paraqitura për përmbushjen e këtij kriteri, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre, si dhe janë të pafirmosura nga ana e investitorit (blerësit).**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

1. *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 ton, jo më pak se 2 copë...*

b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:*

- *Kokore – jo më pak se 8 copë*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – jo më pak se 3 copë*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 2 copë...*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**

1. **Nuk vërtetohet disponimi i 2 (dy) kamionëve të kërkuar, por vetëm 1 (një) të tillë, pasi referuar Çertifikatës datë 06.01.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Bashkia Vlorë, për Kamionin e marrë me qera, marka BENZ, me targa VL 4863 B rezulton se është në përdorim të personit juridik “LABI” Sh.p.k., dhe jo në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës “AVDULI” Sh.p.k., dhe se ky i fundit nuk ka paraqitur një të tillë.**

2. **Nuk vërtetohet disponimi i 2 (dy) matrapikëve, por vetëm 1 (një) të tillë, pasi Fatura Tatimore shitje nr. serie 90679446, datë 19.08.2021/ Nr. i faturës: 46, rezulton se nuk është plotësuar sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre (është e pafirmosur nga shitësi dhe blerësi, si dhe e pavulosur nga shitësi), si dhe nuk është paraqitur dhe kuponi tatimor i kasës për blerjen e këtyre pajisjeve (matrapik).**

3. Për pajisjet: *Gjenerator, dhe ato mbrojtëse: Kokore, Fikëse zjarri...*, dhe tabela paralajmëruese rezulton se Faturat tatimore shitje për blerjen e tyre, nuk janë të plotësuara sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SARDO” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit*:

1. Nuk është plotësuar saktë seksioni A “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”;

2. Nuk është plotësuar seksioni D “Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 (*Makineri, Pajisje*)

a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

1. *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 ton, jo më pak se 2 copë...*

b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:*

- *Kokore – jo më pak se 8 copë*

- *Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë*

- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – jo më pak se 3 copë*

- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 2 copë...*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit*, nuk është deklaruar disponimi i jo më pak se 1 (një) Vinçi 0,5 ton.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 *Afati i kryerjes së punimeve:*

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se grafiku i punimeve nuk është në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur deklarata për dakortësinë mbi mënyrën e financimit dhe realizimin e objektit brenda afatit të përcaktuar.**

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “VALONA KONSTRUKSION” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin B Deklarata “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” nuk është e plotësuar pika 4 e deklaratës.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 (Përvoja të mëparshme)

- *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **100%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- b. Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :
 - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
 - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi Faturat Tatimore Shitje për kontratën e paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **18** (tetëmbëdhjetë) **punonjës** për periudhën **3** (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. **Ku në rast se shpallet fitues, për vërtetimin e këtij kushti përpara nënshkrimit të kontratës, të paraqitet sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së, dokumentacioni si më poshtë:**

- 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Listëpagesa për muajin Gusht 2021.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast të shpalljes si operator ekonomik fitues, përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se,

1. Për inxhinierin elektrik, paga e përcaktuar në Kontratën e punës (noteriale) vjen në kundërshtim me VKM-në Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.
2. CV-të e inxhinierit të Ndërtimit dhe atij Elektrik janë të panënskruara nga ana e tyre.
3. Nuk është paraqitur listëpagesa e muajit Gusht 2021, për vërtetimin nëse këta inxhinierë vazhdojnë të jenë të punësuar pranë op. ekonomik pjesëmarrës.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 8 (tetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se 1 (një) punonjës
- Hidraulik – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Elektriçist – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Murator – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Pllakashtrues – jo më pak se 1 (një) punonjës

- *Suvatues – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Bojaxhi – jo më pak se 1 (një) punonjës*

** Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast të shpalljes si operator ekonomik fitues, përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin: Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi për teknikun e ndërtimit, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën, muaji Korrik 2021 e në vazhdim.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk është paraqitur listëpagesa e muajit Gusht 2021, për vërtetimin nëse këta punonjës vazhdojnë të jenë të punësuar pranë op. ekonomik pjesëmarrës.**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 2 (dy) shoferë të mjeteve të rënda, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën, muaji Korrik 2021 e në vazhdim në rast se mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar duhet të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, nëse shpallet si operator ekonomik fitues, përpara nënshkrimit të kontratës, për secilin të paraqiten:

- *Kontratë pune të vlefshme,*
- *Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,*
- *Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon minimumi 2 (dy) shoferë të mjeteve të rënda, por vetëm 1 (një) të tillë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“RADIKA”** Sh.p.k., me seli: *Dibër, Peshkopi, PESHKOPI, L "GJOK DOCI”*, me numër Nipt-i: **J77304705D**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **10 640 108 (dhjetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e njëqind e tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor